



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 74, datë 15.06.2020

PËR

**MIRATIMIN E EMËRIMIT TË Z. EGI SANTO SI ANËTAR I KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SICRED” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e emërimit të z. Egi Santo, në pozicionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit të Jetës “SiCRED” sh.a., për një periudhë 3-vjeçare.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE